



Pranuar / Dorezuar Punëdhënësi/Prodator Received/Delivory	26.09.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr. Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOPSJK	6271/2023		115



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1075/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, dhe Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1075/2023 të datës 11.08.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted], kundër Vendimit me numër Nr.01-565/2023 të datës 09.08.2023 të Kryetarit të Komunës së Ranillugut, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 25.09.2023, morri këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.1075/2023 e datës 11.08.2023 e parashtruar nga [redacted]
- II. **ANULOHET** Vendimi me numër Nr.01-565/2023 të datës 09.08.2023 i Kryetares së Komunës së Ranillugut.
- III. **OBLIGOHET** Kryetarja e Komunës së Ranillugut, që t'i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Ar sy e t i m

Ankuesja [REDACTED] e punësuar sipas Akt Emërimit me numër Nr.01-576/2022 të datës 17.10.2022 në pozitën e punës „Zyrtare për Rrjet dhe Matje“ në Drejtorin për Urbanizëm, Kadastër dhe Gjeodezi, në Komunën e Ranillugut, më datë 11.08.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 5622/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër Nr.01-565/2023 të datës 09.08.2023 të Kryetarit të Komunës së Ranillugut, përmes së cilit ankuesja është emëruar Menaxhere e Projektit „Ndërtimi i Autoparkut për parkimin e vetura në Komunën e Ranillugut“.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 25.08.2023 ka proceduar kërkesën e ankuesit për përgjigje në ankesë në Komunën e Ranillugut. Ndërsa Këshilli, më datë 04.09.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5622/2023 e parashtruar me datën 11.08.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës; Akt Emërimit me numër Nr.01-576/-2022 i datës 17.10.2022; Aktvendim për shkarkim të drejtorit për urbanizëm, kadaster dhe gjeodezi me numër Nr.01-618/2021 e datës 31.12.2021; Autorizim me numër Nr.01-557/2021 i datës 01.12.2021; Vendim për emërimin e drejtorit me numër Nr.01.708/2019 i datës 03.12.2019; Vendim për emërimin e drejtorit me numër Nr.01-565/2023 i datës 09.08.2023; Diplomë me numër Nr.899 e datës 07.11.2017; Diplomë me numër Nr.791 i datës 23.10.2023; Listë e pagave për për. periudhën 01.08.2023-31.08.2023; Konkurs me numër të referencës Nr.ref.RN00009427 i datës 15.08.2022; Renditja përfundimtare e kandidatëve me numër të procedurës RPC0003166 e datës 11.10.2022; E-mail i datës 19.09.2023; Pliko me numër R 5421937 e datës 01.09.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha provat bashkëngjitura në shkresat e lëndë dhe konstatuar që ankesa e ankueses, është e **bazuar sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i provave të bashkëngjitura në shkresat e lëndës, konstaton se ankuesja [REDACTED] sipas Aktit të Emërimit të datës 17.10.2022 është e punësuar në Komunën e Ranillugut në pozitën e punës „Zyrtare për Rrjet dhe Matje“, ndërsa me datë 09.08.2023 Kryetarja e Komunës së Ranillugut përmes Vendimit me numër Nr.01-565/2023, të njëjtën e ka emëruar Menaxhere të Projektit „Ndërtimi i Autoparkut për parkimin e vetura në Komunën e Ranillugut“.

Ankuesja në ankesën me numër protokollit 56225/2023 të datës 11.08.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër Nr.01-565/2023 të datës 09.08.2023 të Kryetares të Komunës, pretendon se e njëjta ka themeluar marrëdhënie pune më datë 17.10.2022 në Komunën e Ranillugut në pozitën e

punës „Zyrtare për Rrjet dhe Matje“ dhe ende është në periudhë provuese dhe nuk mund ta ushtroj funksionin e „Menaxherit të Projektit“ sepse pozita në fjalë duhet të ushtrohet nga personat që kanë përvojën e nevojshme si dhe trajnimet përkatëse dhe se e njëjta nuk është kompetente për të qenë menaxhere e projektit.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses ndërlidhur me vendimmarrjen nga ana e Kryetares së Komunës së Ranillugut, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 37 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: „1. Nëpunësi që emërohet për herë të parë në Shërbimin Civil i nënshtrohet një periudhe prove, që zgjat një vit nga data e aktit të emërimit. Marrëdhënia e Shërbimit Civil për nëpunësin në periudhë prove është marrëdhënie nën kushtin zgjedhës të konfirmimit në fund të periudhës së provës 2. Qëllimi i periudhës së provës është përgatitja teorike dhe praktike e nëpunësit për kryerjen me sukses të detyrave. 3. Gjatë periudhës së provës, nëpunësi kryen veprimtaritë e detyrueshme të trajnimit dhe kryen detyrat nën kujdesin e një nëpunësi civil të së njëjtës kategori, ose kategorie më të lartë, i cili përcaktohet nga mbikëqyrësi. 4. Në fund të periudhës së provës, institucioni ku nëpunësi është i emëruar, mbështetur në vlerësimin e përgatitjes dhe vlerësimin e rezultateve të punës të nëpunësit për të kryer detyrat e pozitës të punës, vendos: 4.1. konfirmimin e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil të nëpunësit; 4.2. zgjatjen e periudhës së provës një herë të vetme, deri në 6 muaj të tjerë, nëse për arsye të justifikuara ka qenë i pamundur vlerësimi i plotë i nëpunësit; 4.3. moskonfirmimin e nëpunësit dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, nenin 32 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK), për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: „ 1. Nëpunësi që emërohet sipas nenit 30 të kësaj Rregulloreje i nënshtrohet një periudhe pune provuese, që zgjat një (1) vit nga data e fillimit të punës. 2. Puna provuese është përgatitja teorike dhe praktike e nëpunësit për kryerjen me sukses të detyrave të pozitës ku është emëruar“, si dhe nenin 37 dhe 38 të së njëjtës Rregullore që rregullon procedurën e përfundimit të vlerësimit të rezultateve të punës në periudhën provuese respektivisht konfirmimin ose mos konfirmimin e marrëdhënies së punës së nëpunësit civil ku shprehimisht theksohet se : „ 37. Përfundimi i vlerësimit të rezultateve të punës në periudhën provuese 1.Udhëheqësi i njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore, gjashtëdhjetë (60) ditë para përfundimit të punës provuese, kërkon me shkrim nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil që të bëjë vlerësimin e punës provuese. 2.Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë takon nëpunësin civil jo më pak se dyzetepesë (45) ditë para përfundimit të punës provuese dhe bashkëbisedon me të për vlerësimin e punës së tij provuese. 3.Njoftimi për takimin lidhur me vlerësimin e punës provuese të nëpunësit civil i dërgohet nëpunësit së paku tri (3) ditë para datës së takimit. 4.Takimi për vlerësimin e periudhës provuese organizohet me qëllim që udhëheqësi i drejtpërdrejtë dhe nëpunësi civil të bashkëbisedojnë për përmbushjen e detyrave të punës gjatë periudhës provuese. 5.Gjatë takimit, mendimi dhe vërejtjet e nëpunësit civil për realizimin e detyrave të punës së tij merren në konsideratë. “ „38. Konfirmimi ose moskonfirmimi i periudhës provuese 1.Në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë vendos konfirmimin ose mos konfirmimin e vazhdimin të marrëdhënies së punës të nëpunësit civil. 2. Vendimi për konfirmimin apo mos konfirmimin bazohet në vlerësimin e rezultateve në punë. 3. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil vendos konfirmimin ose mos konfirmimin të nëpunësit, të arsyetuar me shkrim, i cili e dërgon tek udhëheqësi i njësisë të menaxhimit të burimeve njerëzore dyzet (40) ditë para përfundimit të punës së tij provuese. 4. Udhëheqësi i njësisë të menaxhimit të burimeve njerëzore, pas marrjes së vendimit të konfirmimit për vazhdimin e

marrëdhënies së punës të nëpunësit civil nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë, konfirmimin ia bashkëngjit dosjes së nëpunësit civil. 5. Në rast të mos konfirmimit nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, merret vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit përkatës 6. Nëse, për shkaqe të justifikuara, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 32 të kësaj rregullore, nuk ka qenë e mundur kryerja e plotë e vlerësimit të nëpunësit në periudhë provuese, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë mund të vendosë, zgjatjen e periudhës së provës, për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj. 7. Udhëheqësi i njësisë të menaxhimit të burimeve njerëzore e informon nëpunësin civil tridhjetë (30) ditë para përfundimit të punës provuese”, dhe ka ardhur në përfundim se Kryetarja e Komunës së Ranillugut me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Nr.01-565/2023 të datës 09.08.2023, me të cilin e ka emëruar ankuesen Menaxhere të Projektit „Ndërtimi i Autoparkut për parkimin e veturave në Komunën e Ranillugut” ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura sepse të njëjtën e ka ngarkuar me detyra shtesë në cilësi të pozitës „Menaxhere të Projektit” pa i konfirmuar vazhdimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil sipas përshkrimit të detyrave të punës dhe titullit të pozitës në të cilën është emëruar në bazë të Aktit të Emërimit me numër Nr.01-576/2022 sipas së cilës ankuesja marrëdhënien e punës e ka themeluar nga data 17.10.2022 andaj mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se pretendimi i ankueses është i bazuar sepse e njëjta në bazë të Akt Emërimit ende është në periudhë pune provuese që zgjat një (1) vit nga data e fillimit të punës konkretisht ankueses periudha provuese i përfundon me datë 16.10.2023.

Prandaj, nga se u tha si më lartë, pas analizimit të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë si dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ekzistojnë arsyet të mjaftueshme që ankesa e ankueses të aprovohet kurse Vendimi me numër Nr.01-565/2023 i datës 09.08.2023 i Kryetares së Komunës së Ranillugut të anulohet pasi që i njëjti është nxjerrë me shkelje procedurale dhe në kundërshtim me dispozitat materiale dhe në kuptim të dispozitave të nenit 52, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji konstaton se një akt administrativ i nxjerrë me shkelje procedurale dhe në kundërshtim me dispozitat materiale është akt i paligjshëm andaj në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli ka anuluar Vendimin me numër me numër Nr.01-565/2023 të datës 09.08.2023 të Kryetares së Komunës lidhur me ngarkimin e detyrave shtesë të ankueses pa e përfunduar periudhën provuese gjegjësisht pa e konfirmuar marrëdhënien e punës sipas Akt Emërimit me numër Nr.01-576/2022 të datës 17.10.2022 .

Në rast të moszbatimit të Vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit

Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1075/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetares së Komunës së Ranillugut;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Ranilugut dhe
- Arkiviot të KPMSHCK-së.